

# Statuti i Bankës ProCredit

## I. Dispozita të përgjithshme

### *Neni 1: Emertimi, Selia dhe Kohezgjatja*

(1) ProCredit Bank (me poshtë: Banka) është një shoqëri anonime, me të gjitha të drejtat, detyrat dhe detyrimet që i takojnë sipas Legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, këtij Statuti dhe gjithë klauzolave ligjore dhe rregullave të aplikueshme.

(2) Emertimi i Bankës është "ProCredit Bank" Sh.A.

(3) Selia e Bankës gjendet tek Tirana e Re, në adresën "Rruga Sami Frasheri".

(4) Banka do të kryejë aktivitetet për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

### *Neni 2: Objekti*

Objekti kryesor i aktivitetit të Bankës është sigurimi i shërbimeve bankare kryesisht për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri, si dhe sigurimi i një dividendi të arsyeshëm për aksionerët e saj.

### *Neni 3: Aktivitetet*

Me qëllim përmbushjen e objektivave të saj, Banka lejohet të kryejë çdo aktivitet bankar dhe financiar në Shqipëri dhe jashtë saj, aktivitete të cilat mund të kryhen nga bankat tregëtare në përputhje me Ligjin "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet ligjore dhe nënligjore të aplikueshme (me pas: Legjislacioni Bankar Shqiptar) si me poshtë vijon:

1. pranim depozitash
2. të japë kredi
3. të ofrojë shërbimin e pagesave dhe arkëtimit
4. të emëtojë dhe administrojë mjete të pagesave
5. të ofrojë garanci bankare (përfshirë këtu emetimin e letrave të kreditit)
6. të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (përfshirë këtu dhe monedhat e huaja)
7. të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit
8. huazim fondesh si dhe blerje ose shitje për llogari të vet, dhe/ose për llogari të klienteve:
  - a. instrumenta të tregut të parave
  - b. letra me vlerë të borxhit
  - c. instrumenta të normës së interesit; dhe
  - d. futura (të ardhme) dhe options në lidhje me letrat me vlerë të borxhit ose instrumenta të normës së interesit.
9. të ushtrojë qerane financiare

10. të shërbejë si agjente financiare ose këshilltare financiare (pa përfshirë këtu shërbimet e përkrahura në pikat 1 dhe 2);
11. këmbime valutore, përfshirë këtu kontrata e se ardhmes (futures) për këmbime valutore;
12. shërbime besimi (trust), përfshirë këtu, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara;
13. shërbim si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
14. shërbime për nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregëtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve,
15. transaksione me metale të çmuara

Banka lejohet të kryejë çdo aktivitetet financiar dhe bankar të sipërpermendur

- a. me kusht që të jenë brenda objektivit të aktivitetit të saj;
- b. me kusht që Banka të jetë e licensuar për kryerjen e këtyre aktivitetëve dhe që Banka të ketë kapitalin e autorizuar që kërkohej nga Legjislacioni Bankar Shqiptar për të kryer aktivitetet e sipërpermendura (kjo aplikohet sidomos për aktivitetet që i takojnë pikave 11. deri në 14.); dhe
- c. duke iu referuar aktivitetëve të përmendura në pikat 8. dhe 9. deri në 14., me kusht që Këshilli Drejtues i Bankës të ketë miratuar të tilla shërbime.

#### ***Neni 4: Viti financiar, Monedha***

- (1) Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.
- (2) Banka duhet të përgatitë pasqyrat e saj financiare vjetore në bazë të Lekut Shqiptar. Përveç kësaj, pasqyrat financiare do të konvertohen në Euro si dhe do të raportohen.

## **II. Kapitali Themeltar**

#### ***„Neni 5: Kapitali Aksioner dhe Aksionet***

- (1) Shuma e kapitali të nënshkruar dhe të paguar në aksione është Euro 11'824'000 (njëmbëdhjetë milion tetëqind e njëzet e katër mijë) e ndarë në 160.000 (një qind e gjashtëdhjetë mijë), secila me vlerë nominale prej Eur 73.90 (shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë).
- (2) Aksionet janë aksione të regjistruara (p.sh. nominative), dhe duhet të regjistrohen në Regjistrin e Aksioneve ( duke pasqyruar emrat dhe adresat e aksionerëve, si dhe numrin dhe vlerën e aksioneve që i takojnë secilit aksioner), që mbahet nga Banka në Tiranë.
- (3) Vetëm aksionerët të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e Aksioneve mund të ushtrojnë të drejtat që u jepen aksionerëve. Mund të leshohen certifikata aksionesh që përfaqësojnë me shumë se një aksion. Nuk ekziston e drejta automatike që për çdo aksion të sigurohet një certifikatë aksioni individuale.

#### ***Neni 6: Struktura e pronësisë në kapital***

Kapitali themeltar nënshkruhet dhe shlyhet me para në dorë në shumat e mëposhtme nga aksioneret e mëposhtem:

Aksioneri	Shuma në EUR	Numri i aksioneve	në %
ProCredit Holding AG	5,173,000	70'000	43,75 %
Fondacioni për Financimin e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve (FEFAD)	2'956'000	40'000	25%
Commerzbank AG	2'364'800	32'000	20%
International Finance Corporation (IFC)	1,330,200	18'000	11,25%

***Neni 7: Rritja e kapitalit themeltar dhe emetimet pasuese te aksioneve***

- (1) Kapitali themeltar i Bankes mund te rritet me votim te Mbledhjes se Asamblesë së Jashtezakonshme te Aksionereve. Nje vendim i tille duhet te bazohet ne nje raport nga Drejtori i Përgjithshëm.
- (2) Kapitali themeltar i Bankes duhet te rritet nepermjet emetimit te aksioneve te reja. Aksionet e emetimeve te mevonshme duhet te jene ne formen e aksioneve te regjistruara dhe mund te jene ose te zakonshme ose aksione preferenciale me pa te drejte vote, me kusht qe legjislacioni i Republikes se Shqiperise te lejoje emetimin e aksioneve preferenciale pa te drejte vote. Çdo aksioner do te kete te drejte te regjistroje aksione te reja ne raport me përqindjen e kapitalit qe zoteron. Kontributet e aksionereve per nenshkrimin e aksioneve te reja duhet te jene plotesisht te paguara me para ne dore brenda dymbedhjete muajve nga data e nenshkrimit. Per sa kohe qe Mbledhja e Asamblese së Jashtezakonshme të Aksionereve nuk merr nje vendim tjetër, kapitali aksioner i Bankes duhet te rritet brenda pese vjetesh data ne te cilen Mbledhja e Asamblese së Jashtezakonshme të Aksionereve ka dhene autorizimin per rritje te kapitalit themeltar.
- (3) Tipi i aksioneve te emetueshme gjatë emetimeve të mëvonshme do te percaktohet nga Mbledhja e Asamblese së Jashtezakonshme të Aksionereve.
- (4) Pavarësisht nga sa më sipër një rritje e kapitalit themeltar të nënshkruar me përfshirje të rezervave vullnetare, fitimeve të mbajtura ose primit të emetimit mund të vendoset në Mbledhjen e Zakonshme të Asamblesë së Aksionerëve

***Neni 8: Zvogëlimi i kapitalit themeltar***

- (1) Zvogëlimi i kapitalit themeltar te Bankes duhet te lejohet nga Mbledhja e Asamblese së Jashtezakonshme të Aksionereve dhe kerkon aprovimin paraprak nga Banka e

Shqiperise. Nje vendim i tille duhet te bazohet ne nje raport te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar i jashtem i emeruar nga Banka. Zvogelimi i kapitalit themeltar do te preke cdo aksioner ne raport me pjesëmarrjen e tij.

- (2) Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet poshte minimumit te kapitalit te kerkuar nga legjislacioni bankar shqiptar.

#### ***Neni 9: Transferimi i aksioneve***

(1) Aksioneret, per te transferuar aksione tek te tretet duhet t'i paraqesin Bankës nje kerkese me shkrim ku te specifikohet numri e aksioneve qe do te transferohen, cmimi i propozuar per transferimin, per cdo aksioner, si dhe te dhena mbi bleresin e aksionit.

(2) Banka, me vendim te Mbledhjes se Asamblese së Jashtezakonshme të Aksionereve mund te hedhe poshte ose te pranoje kerkesen per transferim. Ne qofte se Mbledhja e Asamblese së Jashtezakonshme të Aksionereve nuk merr nje vendim te tille brenda tre muajve nga nga data e dorezimit te kerkeses, kerkesa konsiderohet e miratuar. Megjithate, cdo transferim aksionesh duhet te miratohet paraprakisht nga Banka e Shqiperise, ne qofte se legjislacioni bankar shqiptar e kerkon nje miratim te tille.

- (3) Cdo transferim aksionesh tek te tretet duhet te regjistrohet ne Librin e Aksionereve.

#### ***Neni 10: Ndarja e fitimit***

(1) Raporti i fitimit të Bankës pas taksave i cili do të transferohet në rezervat e detyrueshme dhe/ose statutore do të përcakohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret që i aplikohen bankave në Republikën e Shqipërisë. Fitimi vjetor i mbetur pas taksave duhet te perdoret se pari per te mbuluar humbjet e krijuara (ne qofte se ka).

(2) Fitimi i mbetur pas taksave per nje vit te caktuar pas mbajtjes së fondeve rezervë ne perputhje me paragrafin (1) mundet, me vendim te Mbledhjes se Asamblese së Zakonshme të Aksionereve, (plotesisht ose pjeserisht) konsiderohet si fitime te mbajtura dhe/ose t'i shtohet rezerves vullnetare dhe/ose t'i shperndahet aksionereve ne formen e dividendit ne raport me pjesëmarrjen ne kapital. Zoteruesve te aksioneve preferenciale mund t'u jepen të drejtat preferenciale ne lidhje me ndarjen e fitimit. Te drejta te tilla preferenciale do te vendosen nga Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve.

### **III. Asambleja e Aksionereve**

#### ***Neni 11: Statusi, Ftesat, Kuorum dhe Llojet e Mbledhjeve***

(1) Asambleja e Aksionereve eshte organi me i larte vendimmarrës i Bankës. Çdo aksioner eshte i regjistruar ne Librin e Aksionereve si zoterues i aksioneve te zakonshme te Bankes ka te drejte te ftohet dhe te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Aksionereve.

(2) Ftesat per Mbledhjet e Zakonshme dhe te Jashtezakonshme te Asamblese se Aksionereve (te cilesuara me pas si: Mbledhje te Asamblese se Aksionereve), ku te paraqitet rendi i dites, data, ora dhe vendi ku do te zhvillohet mbledhja, do te dergohet me fax dhe poste te regjistruar

te pakten 15 (pesëmbëdhjete) dite përpara mbledhjes së propozuar. Kryetari i Keshillit Drejtues është përgjegjës për ndarjen në kohën e duhur të ftesave për pjesëmarrjen në Mbledhjen e Asamblesë së Aksionereve. Në mungesë të tij/saj ose në qofte se ngarkohet nga Kryetari i Keshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm në mungesë të tij Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndajë ftesat në kohën e duhur në emër të Kryetarit të Keshillit Drejtues.

(3) Në mungesë të të gjithë anëtarëve të Keshillit Drejtues dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, Mbledhja e Asamblesë së Aksionereve mund të mbledhet sipas procedurës së përcaktuar nga legjislacioni bankar shqiptar.

(4) Si rregull, Mbledhjet e Asamblesë së Aksionereve zhvillohen në selinë e Bankës. Me sugjerim të Kryetarit të Keshillit Drejtues, ato mund të zhvillohen në vend tjetër, përfshirë këtu edhe vendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

(5) Mbledhjet e Asamblesë së Aksionereve konsiderohen se kanë kuorumin, në qofte se aksionerët që zotërojnë dy të tretat e votave, ose përfaqësuesit, janë prezentë.

(6) Asambleja e Aksionereve zhvillon dy lloje Mbledhjesh: Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme të Aksionereve dhe Mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve.

#### ***Neni 12: Mbledhjet e Asamblesë së Zakonshme Aksionereve***

- (1) Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionereve duhet të zhvillohet brenda gjashtë muajve pas mbarimit të vitit financiar, pas përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionereve analizon dhe diskuton raportet mbi veprimtarinë, të përgatitura dhe paraqitura nga Keshilli Drejtues dhe/ose Drejtori i Përgjithshëm dhe me shumicë të thjeshtë të votave të pranishme, ajo:
  - a. miraton pasqyrat financiare vjetore të vitit paraardhës,
  - b. vendos për përdorimin e fitimit ose mbulimin e humbjeve të mundshme
  - c. miraton aktet e Keshillit Drejtues dhe të Drejtorit të Përgjithshëm për vitin financiar paraardhës,
  - d. miraton ekspertin kontabël të pavarur për të kontrolluar pasqyrat financiare për vitin ushtrimor,
  - e. mund të vendose nëse duhen lene rezerva,
  - f. mund të emërojë ose shkarkojë nga detyra anëtarët e Keshillit Drejtues,
  - g. mund të emerojë ose shkarkojë nga detyra anëtarët e Komitetit të Kontrollit;
  - h. mund të vendose për emetimin e obligacioneve,
  - i. mund të miratojë shitje ose dhënie me qera të një pjese të konsiderueshme të aseteve të Bankës, dhe
  - j. mund të marrë vendime të tjera në përputhje me legjislacionin bankar shqiptar dhe këtë Statut.

(3) Në qofte se në Mbledhjen e Zakonshme të Asamblesë së Aksionereve kuorumi nuk është prezent, mbledhja duhet të shtyhet dhe duhet të thirret perseri me të njëjtin rend

dite (delegimet e te drejtave te votave dhe/ose autorizimet e perfaqesuesve do te mbeten te vlefshme per mbledhjen e thirrur serish). Kryetari i Keshillit Drejtues eshte pergjegjes per informimin e sakte te aksionereve per kohen (e cila duhet te jete jo me shpejt se nje dite dhe jo me vone se katermbledhjet dite pas dates se pare te caktuar per mbledhjen) dhe per vendin per mbledhjen e thirrur serish. Ne qofte se ne mbledhjen e shtyre dhe te thirrur serish kuorumi nuk eshte i pranishem brenda gjysem ore nga koha e caktuar per mbledhjen, aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar rregullisht do te formojne kuorumin.

### ***Neni 13: Mbledhjet e Asamblese se Jashtezakonshme të Aksionereve***

(1) Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme të Aksionereve do te thirret nga Kryetari i Keshillit Drejtues ose ne baze te nje kerkese me shkrim nga shumica e anetareve te Keshillit Drejtues ose aksionereve zoterues te te pakten 25% te votave. Kerkesa me shkrim duhet te dorezohet tek Kryetari i Keshillit Drejtues te pakten pesembledhjet dite para dates se propozuar per mbledhje dhe duhet te paraqese rendin e dites. Kryetari i Keshillit Drejtues eshte pergjegjes per dergimin e ftesave me shkrim aksionereve qe do te marrin pjese ne Mbledhjen e Jashtezakonshme te Asamblese se Aksionereve.

(2) Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve mund te analizoje dhe te diskutoje raportet mbi veprimtarine, e pergatitura te paraqitura nga Keshilli Drejtues dhe/ose Drejtori i Përgjithshëm i dhe me shumice prej dy te tretave të votave te pranishme:

- a. ndryshon kete Statut,
- b. vendos per ndryshimin e statusit, bashkimin dhe per shperndarjen e Bankes.
- c. miraton zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar dhe vendos per emetimin e aksioneve te reja, si dhe per llojin e aksioneve qe do te emetohen,
- d. mund te marre vendime te tjera ne perputhje me legjislacionin bankar shqiptar dhe kete Statut.

(4) Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve mund te zhvillohet ne cdo kohe pa ftese te shkruar, ne qofte se te gjithë aksioneret jane te pranishem ose te perfaqesuar rregullisht dhe nese ata vendosin unanimisht per ta thirrur kete mbledhje.

(5) Ne qofte se ne Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme të Aksionereve kuorumi nuk eshte prezent, mbledhja duhet te shtyhet dhe te thirret serish me te njejtin rend dite (delegimet e te drejtave per te votuar dhe/ose autorizimet e përfaqesuesve do te mbeten te vlefshme per mbledhjen e thirrur serish). Kryetari i Keshillit Drejtues eshte pergjegjes per informimin e sakte te aksionereve per kohen (e cila duhet te jete jo me shpejt se nje dite dhe jo me vone se dy muaj pas dates se pare te caktuar per mbledhjen) dhe per vendin e mbledhjes së thirrur serish. Mbledhja e shtyre dhe thirrur serish ka kuorumin e nevojshem ne qofte se aksionerët që zotërojnë 25% të aksionereve jane te pranishem ose te perfaqesuar rregullisht. Ne qofte se nje kuorum i tille nuk eshte i pranishem ne Mbledhjen e Jashtezakonshme te Asamblese se Aksionereve, ajo do te shtyhet dhe do te thirret serish ne te njejten menyre. Ne mbledhjen e dyte te thirrur serish aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar rregullisht formojnë kuorumin.

#### ***Neni 14: Të drejtat për të votuar***

Në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, çdo aksioner i regjistruar me Bankën në Librin e Aksionereve si zotërues i aksioneve të zakonshme ka të drejtën e një vote për çdo aksion të zakonshëm. Të drejtat për të votuar të aksionerëve mund të ushtrohen vetëm në bllok.

#### ***Neni 15: Përfaqësimi***

(1) Aksionerët të cilët janë persona fizikë mund të marrin pjesë në Mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve dhe të ushtrojnë personalisht të drejtën për të votuar. Aksionerët të cilët janë persona juridikë duhet të marrin pjesë në Mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve dhe të ushtrojnë të drejtat për të votuar nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar me prokurë. Një autorizim i tillë duhet t'i paraqitet me shkrim Kryetarit të Këshillit Drejtues përpara Mbledhjes së Asamblesë së Aksionerëve. Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm ose punonjës të tjerë të Bankës nuk janë të lejuar të përfaqësojnë aksionerët në Mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve.

(2) Nëse një aksioner nuk ka mundësi të marrë pjesë në Mbledhjet e Asamblese së Aksionereve ai mund të autorizojë me prokurë një aksioner tjetër ose të tretë për të ushtruar të drejtat e tij/saj të votes. Kryetari i Këshillit Drejtues duhet të njoftohet për delegimin e të drejtave të votes përpara Mbledhjes së Asamblese së Aksionereve. Të drejtat e votes nuk mund t'u delegohen Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm ose punonjësve të tjerë të Bankës.

(3) Gjatë Mbledhjeve të Asamblesë së Aksionerëve, anëtarët e saj mund të bëjnë të njohura pikëpamjet e tyre gojarisht ose me shkrim. Në raste të vecanta, Asambleja e Aksionerëve mund të marrë vendim nëpërmjet votive të paraqitura me postë ose me fax.

(4) Kur është e nevojshme që një vendim të merret me postë ose me fax, Kryetari i Këshillit Drejtues do të njoftojë aksionerët mbi veprimin që duhet marrë dhe do të vendosë, paraprakisht, afatin përfundimtar për dorëzimin e votave, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë. Miratimi me shkrim, për veprimet për t'u ndërmarrë, duhet të jepet nga aksionerët që kanë jo më pak se minimumin e votave të nevojshme për të autorizuar një veprim të tillë në një mbledhje ku të gjitha aksionet janë të pranishme dhe votuara. Aksionerët do të njoftohen menjëherë mbi marrjen e vendimit.

#### ***Neni 16: Kryesimi i Mbledhjeve të Asamblese së Aksionereve dhe Procesverbali i Mbledhjeve***

1) Mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve kryesohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues ose në mungesë të tij/saj nga Zëvendësuesi i tij/saj, ose në mungesë të të dyve nga një anëtar tjetër i Këshillit Drejtues i përcaktuar nga Kryetari dhe kur ky anëtar nuk është përcaktuar nga Kryetari, nga një anëtar i Këshillit Drejtues i caktuar nga anëtarët e Këshillit Drejtues të cilët janë të pranishëm në Mbledhjen në fjalë. Nëse asnjë anëtar i tillë nuk është i pranishëm,

Keshillit Drejtues mund t'ja delegojne mandatin e tyre per mbledhje individuale te Keshillit Drejtues personave te tjere (me perjashtim te Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit te Përgjithshëm ose anetareve te tjere te stafit te Bankes) me ane te nje prokure me shkrim, e cila duhet te dorezohet ne Banke perpara mbledhjes ne fjale. Anetaret e Keshillit Drejtues, sidoqofte, mbajne pergjegjesi per vendimet e personave te cileve ata u kane deleguar mandatin e tyre.

#### ***Neni 20: Kryesimi i Keshillit Drejtues***

Keshilli Drejtues do te zgjidhe mes anetareve te tij nje kryetar dhe nje ose disa zevendesa per kohezgjatjen e mandatit te tyre. Zgjedhja vëzhgohet nga anetari me i vjeter i Keshillit Drejtues. Ne mungese te Kryetarit te Keshillit Drejtues detyrat e tij/saj duhet te permbushen nga zevendesi/zevendesat e tij/saj .

#### ***Neni 21: Zgjatja e Mandatit, Doreheqja dhe Shkarkimi nga Detyra***

- (1) Anetaret e Keshillit Drejtues zgjidhen per nje periudhe prej dy vjetesh dhe mund te rizgjidhen. Megjithate, mandati i tyre nuk mbaron deri sa te mos jene zgjedhur pasardhesit e tyre. Anetaresia e Keshillit Drejtues mbaron perpara afatit ne qofte se:
  - a. nje anetar i Keshillit Drejtues jep doreheqjen nga mandati i tij/saj duke i paraqitur ne lidhje me kete fakt nje deklarate Kryetarit te Keshillit Drejtues ose tek nje prej zevendesve te tij/saj, me afat lajmërimi një mujor, e cila mund te hidhet poshte nga Asambleja e Aksionereve;
  - b. nje anetar i Keshillit Drejtues shkarkohet nga detyra ne perputhje me Nenin 18 (2);
  - c. nje anetar i Keshillit Drejtues shkarkohet nga detyra me vendim te Asamblese se Aksionereve; ose
  - d. nje anetar i Keshillit Drejtues shkarkohet nga detyra nga autoritetet shtetërore ne perputhje me legjislacionin bankar shqiptar.

(2) Ne rastet e pershkruara ne paragrafin (1) a) - d) ose ne qofte se nje anetar i Keshillit Drejtues vdes, thirret menjehere Mbledhja e Zakonshme e Asamblese se Aksionereve per te zgjedhur nje pasardhes. Pasardhesi mund të zgjidhet me vendim me shkrim te firmosur rregullisht nga secili aksioner.

#### ***Neni 22: Detyrat dhe pergjegjesite e Keshillit Drejtues***

Detyrat specifike dhe pergjegjesite e Keshillit Drejtues janë si më poshtë vijon

- a. të përcaktojë politikat e Bankës;
- b. te aprovojë strukturën organizative të Bankës dhe politikat kryesore operationale, me perjashtim të rastit kur këto janë aprovuar shprehimisht nga Asambleja e Aksionerëve;
- c. te caktojë dhe, nese eshte e nevojshme, te zevendesojë anëtarët e Drejtorisë, te jape udhezime dhe instruksione per aktivitetet e Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm , dhe te përcaktojë kushtet per kontratat e tyre te punes;



- d. te miratoje planin vjetor te biznesit te hartuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe te mbikqyre zbatimin e tij, duke perfshire ketu kriteret per te përcaktuar borxhet e keqija, si dhe per te krijuar rezervat per borxhe te keqija;
- e. te diskutoje dhe te miratoje raporte mbi veprimtarine e Bankes gjate vitit financiar, si dhe t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve pasqyrat financiare vjetore dhe raportet vjetore;
- f. te paraqese te gjitha raportet e eksperteve kontabel te jashtem ne Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve;
- g. te pergatise propozime per ndryshime te Statutit per t'u aprovuar ne Mbledhjet e Asamblese se Jashtezakonshme të Aksionereve
- h. te pergatise sugjerime per Asamblene e Pergjithshme te Aksionereve dhe, nepermjet kryetarit te tij, te thërrase Mbledhje te Asamblese së Zakonshme dhe te Jashtezakonshme te Aksionereve;
- i. te vendose rreth krijimin, transferimit, hapjes dhe mbylljes se degeve dhe zyrave perfaqesuese.

### ***Neni 23: Mbledhjet e Keshillit Drejtues dhe Vendimet***

- (1) Mbledhjet e Keshillit Drejtues duhet te zhvillohen te pakten kater here ne vit (nje per cdo tre muaj). Ftesat per mbledhjet e Keshillit Drejtues, ku te percaktohet rendi i dites, data, ora dhe vendi i mbledhjeve, duhet te dergohen me fax ose poste te rregjistruar te pakten 15 (pesembedhete) dite perpara mbledhjes se propozuar. Kryetari i Keshillit Drejtues eshte pergjegjes per shperndarjen e ftesave te tilla në kohen e duhur tek anetaret e Keshillit Drejtues. Në mungese te tij/saj ose me porosi te tij, Drejtori i Përgjithshëm duhet të shpërndaje ne kohen e duhur ftesat, ne emer te Kryetarit te Keshillit Drejtues.
- (2) Mbledhjet te paplanifikuara te Keshillit Drejtues mund te thirren ne cdo kohe me shkrim nga Kryetari i Keshillit Drejtues ose me vendim te Asamblese se Aksionereve, ose me kerkese me shkrim te te pakten dy anetareve te Keshillit Drejtues.
- (3) Si rregull, mbledhjet e Keshillit Drejtues zhvillohen ne seline e Bankes. Me sugjerim te Kryetarit te Keshillit Drejtues, ato mund te behen ne një vend tjetër, perfshire ketu dhe vendet jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
- (4) Keshilli Drejtues konsiderohet se ploteson kuorumin kur te gjithë anetaret jane te ftuar dhe kater te pestat e anetareve jane te pranishem. Anetaret e Keshillit Drejtues mund te marrin pjese ne Mbledhje permes telefonit ose video-konference, ne raste te vecanta. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem.
- (5) Vendimet e Keshillit Drejtues mund të merren me anë të postës, faxit, telefonit ose video-konferencës, duke u siguruar që asnjë anëtar i Keshillit Drejtues të mos ketë vërejtje për miratimin e një procedure të tillë.
- (6) Kur është e nevojshme që një vendim të merret me anë të postës ose faxit, procedura që do të ndiqet është për analogji si në nenin 15 pika (4)
- (7) Pas Mbledhjes së Asamblese së Aksionereve ne te cilen te gjithë anetaret e Keshillit Drejtues jane zgjedhur ose rizgjedhur rregullisht, nje Mbledhje e Keshillit Drejtues duhet te zhvillohet pa ndjekur procedurat e mësipërme.
- (8) Keshilli Drejtues mund te percaktoje rregullat e tij te brendshme te funksionimit.

***Neni 24: Pjesëmarrja e personave të tjerë dhe procesverbalit i Mbledhjes së Keshillit Drejtues***

- (1) Kryetari i Keshillit Drejtues mund të ftojë Drejtorin e Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm ose persona të tjerë për të marrë pjesë në Mbledhjet e Keshillit Drejtues.
- (2) Materiali i diskutimeve në mbledhjen e Keshillit Drejtues hidhet në procesverbal i cili firmoset nga Kryetari i Keshillit Drejtues. Përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit është Kryetari i Keshillit. Ai/ajo mund, megjithatë të caktojë një person tjetër përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit.

***Neni 25: Pagesa e Anëtarëve të Keshillit Drejtues***

Anëtarët e Keshillit Drejtues nuk do të paguhet për kryerjen e detyrave të tyre, por do të marrin një dietë të pershtatshme për shpenzimet. Sasia e dietes do të përcaktohet here pas here nga Asambleja e Aksionereve.

***Neni 26: Kufizimet***

Anëtarët e Keshillit Drejtues dhe familjet e tyre nuk lejohen të marrin kredi ose garanci nga Banka. Ky kufizim gjithashtu aplikohet për firmat ku anëtarët e Keshillit Drejtues kanë pjesëmarrje.

**V. Komiteti i Kontrollit**

***Neni 27: Statusi dhe Anëtarësia***

- (1) Banka vezhgohet nga një Komitet Kontrolli, anëtarët e të cilit të zgjidhen nga Asambleja e Aksionereve. Keshilli i Eksperteve Kontabel nuk do të varet ose të influencohet në kryerjen e detyrave të tij nga Drejtori i Përgjithshëm.

Komiteti i Kontrollit raporton para Keshillit Drejtues dhe Asamblese së Aksionereve.

- (2) Numri i anëtarëve të Komitetit të Kontrollit duhet të jete të pakten 3.

***Neni 28: Kushtet për Zgjedhje dhe Perfaqësimi***

Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm si dhe punonjësit e tjerë të Bankës nuk mund të jenë anëtarë të Komitetit të Kontrollit. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit duhet të plotësojnë kriterin që duhet të përmbushin anëtarët e Keshillave të Eksperteve Kontabel në përputhje me legjislacionin bankar shqiptar. Anëtarët e rinj të Komitetit të Kontrollit duhet të miratohen nga Banka e Shqipërisë. Anëtarët e rinj të Komitetit të Kontrollit mund t'ua delegojnë mandatin e tyre për mbledhje individuale të Komitetit të Kontrollit personave të tjerë (përveç Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm ose punonjësve të tjerë të Bankës) me anë të një prokure të shkruar, e cila i dorëzohet Bankës përpara fillimit të mbledhjes në fjalë. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit marrin përgjegjësinë për vendimet e personave të cilëve ata u delegojnë mandatin e tyre.

### ***Neni 29: Kryesimi i Komitetit të Kontrollit***

Komiteti i Kontrollit duhet të zgjedhë ndërmjet anetareve të tij Kryetarin dhe një ose disa zëvendesa për kohezgjatjen e mandatit të tyre. Zgjedhja mbikeqyret nga anetari më i vjetër i Komitetit të Kontrollit. Në mungesë të Kryetarit të Komitetit të Kontrollit, detyrat e tij/saj kryhen nga zëvendesat e tij/saj.

### ***Neni 30: Zgjatja e Mandatit, Doreheqja dhe Shkarkimi nga Detyra***

Anetarët e Komitetit të Kontrollit zgjidhen për një periudhë prej dy vjetësh dhe mund të rizgjidhen. Megjithatë, mandati i tyre nuk mbaron derisa të mos jenë zgjedhur pasardhësit e tyre. Anetësia e Keshillit Drejtues mbaron përpara afatit në qoftë se:

- a. një anetar i Keshillit të Eksperteve Kontabel jep doreheqjen nga mandati i tij/saj duke dorëzuar një deklaratë për këtë gjë tek Kryetari i Keshillit Drejtues ose tek një nga zëvendësuesit e tij/saj, me afat lajmërimi njëmuji, e cila mund të hidhet poshtë nga Asambleja e Aksionereve;
- b. një anetar i Komitetit të Kontrollit shkarkohet nga detyra me vendim të Asamblese së Aksionereve; ose
- c. një anetar i Komitetit të Kontrollit shkarkohet nga detyra nga autoritetet shtetërore në përputhje me legjislacionin bankar shqiptar.

(2) Në rastet e përshkruara në paragrafin (1) a) - c) ose në qoftë se një anetar i Komitetit të Kontrollit vdes, për këtë qëllim duhet të mbledhjet një Mbledhje e Asamblese së Zakonshme të Aksionereve në mënyrë që të zgjedhë një pasardhës. Pasardhësi mund të zgjidhet me vendim me shkrim të firmosur nga secili aksioner.

### ***Neni 31: Të drejtat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komitetit të Kontrollit***

(1) Detyrat specifike dhe përgjegjësitë e Komitetit të Kontrollit janë si më poshtë:

- a. të mbikeqyre dhe të vëzhgojë procedurat e kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm për t'u siguruar që janë kryer në mënyrë të duhur, të mbikeqyre përputhshmërinë e kontabilitetit dhe procedurave të kontrollit të brendshëm me legjislacionin bankar shqiptar, dhe të auditojë llogaritë e Bankës dhe regjistrimet;
- b. të mbikeqyre zbatimin e vendimeve të Keshillit Drejtues;
- c. të paraqesë opinionet për çdo çështje të parashtruar nga Keshilli Drejtues ose Asambleja e Aksionereve; dhe
- d. të mbikeqyre që aktivitetet e Bankës kryhen në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin bankar shqiptar dhe këtë Statut.
- e. Të zgjedhë dhe t'i paraqesë për miratim Asamblesë së Aksionerëve ekspertin kontabël të autorizuar për vitin financiar ushtrimor.
- f. T'i paraqesë Asamblesë së Aksionerëve vlerësimin – kur një vlerësim i tillë kërkohet nga Banka e Shqipërisë – e raporteve të ekspertit kontabël të autorizuar.

(2) Me kërkesë të tij, Komiteti i Kontrollit mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm.

- (3) Per te siguruar informacionin e nevojshem në kryerjen e funksioneve te kontrollit, anetaret e Komitetit të Kontrollit mund te shohin personalisht cdo dokument te Bankes. Staf i Bankes eshte i detyruar te ndihmojë Komitetin e Kontrollit ne kryerjen e detyrave te tij.
- (4) Auditorët e Brendshem te Bankes duhet t'i raportojne rregullisht Komitetit të Kontrollit. Komiteti i Kontrollit mund t'u kerkoje Auditorëve të Brëndshëm të Bankes te bejne kontrole te vecanta, si dhe te pergatisin raporte per ceshtje te vecanta.

#### ***Neni 32: Mbledhjet e Komitetit të Kontrollit dhe Vendimet***

- (1) Mbledhjet e Komitetit të Kontrollit duhet te thirren te pakten kater here ne vit (nje per cdo tre muaj). Ftesat per mbledhjet e Komitetit Ekzaminues, ku paraqitet rendi i dites, data, ora, vendi i mbledhjeve, duhen derguar me fax ose poste te regjistruar te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes se propozuar. Kryetari i Komitetit të Kontrollit eshte pergjegjes per shperndarjen e ftesave ne kohen e duhur tek anetaret e Komitetit të Kontrollit. Ne mungese te tij/saj ose me propozim nga ai/ajo, Drejtori i Përgjithshëm (në mungesë të tij Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm) duhet te shperndaje ne kohen e duhur ftesat, ne emer te Kryetarit te Komitetit të Kontrollit.
- (2) Mbledhje te paplanifikuara te Komitetit të Kontrollit mund te thirren me shkrim ne cdo kohe nga Kryetari i Komitetit të Kontrollit ose me kerkese te Kryetarit te Keshillit Drejtues, ose me vendim te Asamblese se Aksionereve.
- (3) Si rregull, mbledhjet e Komitetit të Kontrollit zhvillohen ne seline e Bankes.
- (4) Komiteti i Kontrollit konsiderohet se ploteson kuorumin kur te gjithë anetaret jane te ftuar dhe dy te tretat e anetareve jane te pranishem. Anetaret e Komitetit të Kontrollit ne raste te vecanta mund te marrin pjese ne Mbledhje permes telefonit ose video-konferences. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem.
- (5) Vendimet e Komitetit të Kontrollit merren ndermjet mbledhjeve me anë të postës ose faksit. Procedura që do të aplikohet kur vendimet merren me anë të postës, faksit, telefon- ose video-konferencës vendoset nga Kryetari i Komitetit të Kontrollit (perfshire ketu marrjen e vendimeve me ane te postes, faksit, telefonit ose video-konferences) me kusht qe asnje anetar i Komitetit të Kontrollit te mos kundershtojte per adoptimin e nje procedure te tillë.
- (6) Komiteti i Kontrollit mund te caktojte rregullat e tij te brendshme të procedures.

#### ***Neni 33: Pjesëmarrja e personave te tjere dhe mbajtja e procesverbalit te Mbledhjes se Komitetit të Kontrollit***


- (1) Kryetari i Komitetit të Kontrollit mund te ftojte persona te tjere per te marre pjese ne Mbledhjet e Komitetit të Kontrollit.
- (2) Gjate Mbledhjeve te Komitetit të Kontrollit mbahet procesverbal i cili firmoset nga Kryetari i Komitetit të Kontrollit. Kryetari i Komitetit të Kontrollit eshte pergjegjes per mbajtjen e procesverbalit. Ai/ajo mund te caktojte nje person i cili te jete pergjegjes per mbajtjen e procesverbalit.

#### ***Neni 34: Shpërblimi i Anetareve te Komitetit të Kontrollit***

Anetaret e Komitetit të Kontrollit nuk duhet të paguhet për kryerjen e detyrave të tyre, por të marrin një dietë të pershtatshme për shpenzimet. Shuma e dietës duhet të përcaktohet here pas here nga Asambleja e Aksionereve.

#### ***Neni 35: Kufizimet***

Anetare të Komitetit të Kontrollit dhe familjet e tyre nuk mund të marrin kredi ose garanci nga Banka. Ky kufizim gjithashtu aplikohet për firmat në të cilat anetaret e Komitetit të Kontrollit kanë pjesëmarrje.



### **VI. Drejtimi i Bankes**

#### ***Neni 36: Drejtorët ekzekutivë***

- (1) Për të organizuar veprimet e biznesit të Bankës dhe për të kryer veprimet e përditshme dhe gjithë aktivitetet e Bankës brenda kuadrit të politikës së biznesit të përcaktuar nga ky Statut, Këshilli Drejtues emëron një Drejtor të Përgjithshëm dhe një ose më shumë Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm (drejtorë ekzekutivë). Në mungesë ose në pamundësi për të vepruar si Drejtor i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm do të kryejnë detyrat dhe marrin përsipër përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm.
- (2) Drejtorët ekzekutivë emërohen dhe shkarkohen nga posti me vendim të Këshillit Drejtues dhe emërohen për një periudhë prej 2 vjetësh. Ata mund të riemërohen dhe mbikëqyren nga Këshilli Drejtues.
- (3) Drejtori i Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm do të kryejnë detyrat e tyre në interesin më të mirë të aksionereve të Bankës dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin bankar shqiptar dhe këtë Statut, si dhe nga vendimet e tjera të Asamblese së Aksionereve dhe të Këshillit Drejtues.
- (4) Një person mund të emërohet si Drejtor i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtor (nëse ka) vetëm nëse ai/ajo i plotëson kërkesat e aplikueshme të vendosura sipas legjislacionit bankar shqiptar. Drejtori i Përgjithshëm i ri, Zëvendës Drejtorët e rinj duhet të miratohen nga Banka e Shqipërisë.
- (5) Drejtori i Përgjithshëm mund t'ia delegojë detyrat dhe të drejtat e tij anëtarëve të stafit të Bankës. Sidoqoftë, ai është përgjegjës për vendimet e tyre.

#### ***Neni 37: Perfaqësimi i Bankes dhe delegimi i kompetencave***

- (1) Banka do të perfaqësohet tek të tretet nga dy drejtorë ekzekutivë, përjashtuar rastin kur ligjet e Republikës së Shqipërisë, legjislacioni Bankar Shqiptar ose ky Statut ia japin shprehimisht këtë të drejtë Këshillit Drejtues. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm mund të ndryshohen ose të kufizohen me vendim të Asamblese së Aksionereve.
- (2) Banka duhet të përgatise një listë personash të Bankes të autorizuar për të nënshkruar, e cila duhet të mbaje datën e hyrjes në fuqi, emrin, pozitën dhe një kopje të firmës për çdo person të autorizuar, për të firmosur në emër të Bankes dhe një specifikim të

kompetences te cdo personi per te nenshkruar. Lista e personave te autorizuar per te nenshkruar duhet te firmoset nga Drejtori i Përgjithshëm. Banka duhet te paraqese një liste të tillë te treteve me kerkese te tyre.

***Neni 38: Doreheqja dhe shkarkimi nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm (Zëvendës Drejtorit)***

(1) Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit mbaron perpara afatit ne qofte se:

- a. Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit heq dore nga mandati i tij/saj me dorezimin e nje deklarate tek Kryetari i Keshillit Drejtues ose te nje nga zevendesat e tij/saj, nje muaj ne avance, e cila mund te hidhet poshte nga Keshilli Drejtues;
- b. Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit shkarkohet nga detyra me vendim te Keshillit Drejtues; ose
- c. Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit shkarkohet nga detyra nga autoritetet shtetërore ne perputhje me legjislacionin bankar shqiptar.

(2) Ne rastet e pershkruara ne paragrafin (1) a)-c) ose nese Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit vdes, per kete duhet te behet nje mbledhje e Bordit Drejtues ne menyre qe te zgjedhe nje pasardhes. Pasardhesi mund te zgjidhet me vendim te shkruar e firmosur per kete nga cdo aksioner.

(3) Kur Drejtori i Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorët janë shkarkuar nga detyra ose janë në pamundësi te perfaqesoje Banken, Kryetari i Keshillit Drejtues duhet te marre persiper te drejtat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm derisa te zgjidhet nje pasardhes nga Keshilli Drejtues.

***Neni 39: Kufizimet***

Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit dhe familjet e tyre nuk mund te marrin kredi ose garanci nga Banka. Ky kufizim gjithashtu aplikohet per firmat ne te cilat Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit kanë pjesëmarrje.

## **VII. Auditimi i Brendshem**

***Neni 40 : Statusi dhe Detyrat***

(1) Banka duhet te kete nje Departament të Auditimit të Brendshëm i cili te jete pergjegjes per kryerjen e funksioneve te auditimit të brendshëm. Komiteti i Kontrollit eshte pergjegjes per zgjedhjen dhe punesimin e personelit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm. Drejtori i Përgjithshëm do të paraqesë kandidatë të mundshëm nëse kjo kërkohet për të siguruar kryerjen ne menyren e duhur të funksioneve te ekspertimit kontabel te brendshem. Keshilli Drejtues duhet te informohet nga Komiteti i Kontrollit rreth emerimit te Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm dhe ka te drejte ta hedhe poshte kete emerim. Përfundimi i kontrates se punes së Drejtorit të

Departamenti të Auditimit të Brendshëm nga Komiteti i Kontrollit duhet te miratohet nga Keshilli Drejtues.

- (2) Departamenti i Auditimit të Brendshëm duhet te mbeshtetet ne kryerjen e detyrave te tij/saj nga stafi i Bankes dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës.
- (3) Departamenti i Auditimit të Brendshëm eshte pergjegjes per pergatitjen e nje plani auditimi të brendshëm, ku te paraqitet se si Departamenti i Auditimit të Brendshëm do te realizoje mbikeqyrjen në perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, legjislacionin bankar shqiptar, kete Statut, si dhe me vendimet e Asamblese se Aksionereve, Keshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe nje raport vjetor auditimi mbi aktivitetet e auditimit te kryera gjate vitit ne fjale (perfshire ketu vlerësimet). Te dy raportet duhet t'i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm, Komitetit të Kontrollit dhe Keshillit Drejtues.
- (4) Departamenti i Auditimit të Brendshëm eshte pergjegjes per kryerjen e kontroleve specifike me kerkese të Drejtorit të Përgjithshëm, Komitetit të Kontrollit dhe te Keshillit Drejtues.
- (5) Për aktivitetet e tij/saj të përditshme Departamenti i Auditimit të Brendshëm duhet t'i raportojë Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, ai/ajo duhet t'i raportojë rregullisht Komitetit të Kontrollit.

#### ***Neni 41: Procedurat në Raste Parregullish***

(1) Ne qofte se gjenden parregullsi, Auditimi i Brendshëm duhet te pergatise nje raport qe i dorezohet Drejtorit të Përgjithshëm dhe personit (ose personave) pergjegjes per parregullsite. Ketij person (ose personave) duhet t'i jepet nje jave kohe per te raportuar me shkrim per parregullsite e gjetura si dhe per te paraqitur masat se si ai ajo synon të marre per te rregulluar gjendjen dhe/ose të menjanoje parregullsi të tilla në të ardhmen.

(2) Ne qofte se Auditimi i Brendshem zbulon raste te korrupsionit ose ka prova te forta per nje rast te tille, ai/ajo duhet menjëhere te informoje Drejtorin e Përgjithshëm.

(3) Eksperti Kontabel i Brendshem duhet te raportoje direkt ne Komitetin e Kontrollit dhe ne Keshillin Drejtues nese ai/ajo eshte i mendimit qe Drejtori i Përgjithshëm ka deshtuar ne marrjen e masave te duhura lidhur me ceshtjet e ngritura prej tij/saj, dhe nëse nje deshtim i tille mund te kete nje efekt te mprehte negativ per Banken.

(4) Nese Auditimi i Brendshëm ka zbuluar nje rast te korrupsionit ose ka prova te forta per nje rast te tille ku mund te jete perfshire Drejtori i Përgjithshëm ose Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm, ai/ajo duhet menjehere te informoje Kryetarin e Komitetit të Kontrollit si dhe Kryetarin e Keshillit Drejtues.

### **VIII. Raportimi**

#### ***Neni 42: Raportimi***

(1) Keshilli Drejtues gezon te drejten për t'u pajisur nga Drejtori i Përgjithshëm me informacionin e mëposhtem:

- Pasqyrat financiare gjysem-vjetore te pa audituara nga ekspertët kontabël të jashtëm, të përgatitura sipas Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS), përfshirë bilancin dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe informacion mbi transaksionet financiare me shoqëritë e lidhura. Këto pasqyra te dorëzohen brenda 2 muajve nga fundi i periudhës të cilës ato i referohen.

- Pasqyrat financiare vjetore të miratuara dhe të përgatitura nga eksperte kontabel me reputacion ndërkombëtar sipas standarteve të IAS. Raporte të tilla duhet të shpërndahen sa të përgatiten, por në çdo rast brenda 120 ditësh nga fundi i periudhës së cilës i referohen.

- Raporte mujore që mbulojnë aspektet e mëposhtme të portofolit të kredive, brenda 10 diteve pas përfundimit të secilës periudhe:

- Numri dhe vëllimi i kredive të dhena (të dhëna mujore dhe të agreguara),
- Numri dhe vëllimi i kredive të disbursuara
- Analiza e kredive në vonesë në portofol sipas numrit dhe vëllimit, përfshirë këtu përqindjen e kredive në vonesë dhe profilizimin sipas ditëve në vonesë.

Keto raporte duhet të sigurohen për Bankën në tërësi si dhe për degët vec e vec.

- Njoftimi i zhvillimeve ose situatave të cilat mund të kenë efekt negativ në punët ose veprimtarinë e Bankës

- Njoftimi i ndonjë ndryshimi negativ në kërkesat ligjore mbi rezervat, likuiditetin, mjaftueshmërinë e kapitalit, dhe kërkesat e thesarit të Republikës së Shqipërisë.

- Njoftimi mbi të gjitha porositë apo vërejtjet që Banka ka marrë nga Banka e Shqipërisë, autoritetet tatimore, gjykatat, ose autoritete të tjera shtetërore, apo mbi çfarëdo masë të dhënë nga keto autoritete lidhur me Bankën.

(2) Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës që informacioni të dorëzohet në kohë, rregullisht, si dhe që të jetë i saktë dhe i plotë.

## **IX. Klauzola Përfundimtare**

### ***Neni 43: Likuidimi i Bankes***

Mbledhja e Asamblese së Jashtëzakonshme të Aksionereve mund të vendosë likuidimin e Bankes. Procesi i likuidimit duhet të bëhet në përputhje me ligjet e aplikueshme të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin bankar shqiptar.


### ***Neni 44: Ligjet e zbatueshme***

(1) Për çdo aspekt që nuk mbulohet nga ky Statut, zbatohen ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit bankar shqiptar.



Personi qe kryeson Mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme të Aksionereve qe miratoi kete Statut, duhet te konfirmoje me firmen e tij/saj qe ky Statut eshte miratuar rregullisht ne perputhje me proceduren e pershkruar.

Nenshkruar me 31 Tetor 2006



Drejtues i mbledhjes se Asamblese se Aksionereve

Sekretar I mbledhjes se Asamblese  
se Aksionereve

Përktheu: Lila Shalosh  
Kualitete